



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.416/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Ramush Bardiqi kryesues, Kujtim Pasuli dhe Hajriz Hoti anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur më 09.02.2025, merr këtë.

#### VE N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e subjektit politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, Anr.416/2025, e datës 06.02.2025, të ushtruar kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 09.02.2025.

#### A r s y e t i m

Me datë 06.02.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesën e identifikuar me numër Anr.416/2025, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, në të cilën pretendohet se më datë 05 shkurt 2025, në ora 13:48/h, mbështetësja e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, aktualisht Këshilltare politike e Kryeministrit z. Albin Kurti, znj. Fëllanza Podrimja ka publikuar një postim në profilin e saj në rrjetin social Facebook, në të cilin ndër të tjerash shkruan "*Ata që vodhën dhe mashtruan këtë popull, tani duan që me çdo kusht të rikthehen në pushtet - nuk duan të pranojnë se Kosova po bëhet hap pas hapi dhe CEP MË CEP,*" gjuhë e cila përmban nxitje, urrejtje, ofendim, denigrim dhe njëherit shprehë ngjyrimë përçmuese ose nënvlerësuese për partitë kundërshtarë të Lëvizjes Vetëvendosje, e cila partive të cilat duan të rikthehen në pushtet (në këtë rast partive opozitare) i referohet si "*Ata që vodhën e mashtruan këtë popull*".

Për qëllime të argumentimit të afatshmërisë së ankesës, PDK, njoftoj PZAP se shpërndarja e postimit në rrjetin social Facebook nga znj. Fëllanza Podrimja është bërë më 05 shkurt 2025, në ora 13:48/h dhe se postimi vazhdon të jetë ende aktiv në profilin e të njëjtit.

PDK vlerëson se në veprimet e znj. Fëllanza Podrimja janë konsumuar të gjitha elementet e veprimit të ndaluar, të përcaktuar në nenin 34, paragrafi 1, nën paragrafi. 1.11 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur ankesës si provë postimin e publikuar në profilin e znj. Fëllanza Podrimja në rrjetin social Facebook; <https://www.facebook.com/fellanza/posts/pfbid0R4LcD7CqWyfuwhz02sm5qRvetnLgKrVCufH94f6voneXpPjHk2bqnXVQGvnjrYDY1>; si dhe screenshot nga postimi i znj. Fëllanza Podrimja, në të cilën dëshmohet data dhe koha e publikimit të postimit me tekst shoqërues, e cila përmban gjuhë të urrejtjes dhe nxitjes.

Në përgjigjen në ankesë të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, theksohet se nga pretendimet ankimore të ankuesit dhe provat e bashkangjitura ankesës në asnjë rrethanë nuk mund të provohet fakti se znj. Fëllanza Podrimja me postimin e shkrimit në Facebook ka pas për qëllim nxitjen e urrejtjes dhe përçarje meqenëse ky postim nuk është i drejtuar ndaj një personi, grupi apo subjekti politik, dhe konsiderojmë se ky shkrim është brenda korpusit të rregullave që janë paraparë në Kodin e Mirësjelljes. Po ashtu në përgjigje theksohet se znj. Podrimja me rastin e pranimit të ankesës së palës kundërshtare ka edituar/ndryshuar tekstin e këtij shkrimi duke i hequr fjalët me të cilat ankuesi pretendon se e njëjta ka shkelur dispozitat e nenit 34 paragrafi 1 pika 1.11 i LZP-së. Përgjigjes në ankesë i ka bashkangjitur si provë, foto (shkrimi i modifikuar pas pranimit të ankesës)

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoi pretendimet ankimore gjeti se:

#### **Ankesa është e pabazuar**

Për faktin se pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore dhe përgjigjen në ankesë, ka gjetur se postimi i publikuar në rrjetin social i mbështetëses së subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, znj. Fëllanza Podrimja, duke përdorur fjalë me këtë përmbajtje: *"Ata që vodhën dhe mashtruan këtë popull, tani duan që me çdo kusht të rikthehen në pushtet - nuk duan të pranojnë se Kosova po bëhet hap pas hapi dhe CEP MË CEP,"* sipas vlerësimit të panelit deklarimi i tillë, nuk mund të quhet gjuhë denigruese apo gjuhë urrejtëse, nuk nxit ndonjë person të kryej ndonjë akt të dhunës dhe nuk cenon nenin 34 paragrafi 1, nën paragrafi. 1.11 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë.

Duke i vlerësuar këto deklaramë përmes postimit në rrjet social të mbështetëses së subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, znj. Fëllanza Podrimja, Paneli vlerëson se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me gjuhë denigruese dhe të urrejtjes në raport me subjektet politike që marrin pjesë në garën zgjedhore, fjalimet e tilla të përdorura në këtë rast konsiderohen se hyjnë në diskursin e fushatës zgjedhore, dhe nuk mund të konsiderohet se përdorimi i një gjuhe të tillë mund të nxit ose provokon një person tjetër për të kryer një akt dhune kundër personave të tjerë ose pasurisë,

Andaj paneli vlerëson se deklarimi i lartcekur nga ana e mbështetëses së subjektit politik LVV, nuk konsiderohet se është në kundërshtim me nenin 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11), e LZP-së, në të cilin nen përcaktohet se "*Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij) ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: 1.11) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë.*

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar nenin 117 paragrafi 3, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr.416/2025, me datën 09.02.2025

Kryesuesi Panelit  
Ramush Bardiqi



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.